

VENDIM
Nr. 71/2020

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË
PËR ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE HARTIMIN E NJË
RAPORTI PËRMBLEDHËS DHE INFORMUES, PËR GJETJET DHE
KONKLuzionET QË KANË NXJERRË VERIFIKIMET E KRYERA NGA
INSTITUCIONET PËRKATËSE NË SHQIPËRI, PËR ÇËSHTJET E RAPORTIT
TË ANËTARIT TË ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË
EVROPËS, *DICK MARTY*, PËR BASHKËPUNIMIN DHE ROLIN PËR TË CILIN
PRETENDOHET SE KANË LUAJTUR PËRFAQËSUES POLITIKË SHQIPTARË
OSE INSTITUCIONE PUBLIKE SHQIPTARE, NËPËRMJET VEPRIMEVE DHE
MOSVEPRIMEVE, NË NDIHMË TË SË ASHTUQUAJTURËS VEPRIMTARI
KRIMINALE E DREJTUESVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

(Ndryshuar me vendimin nr. 23/2021, datë 22.2.2021¹)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kërkesën e 18 deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues, për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të APKiE-s, *Dick Marty*, për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të UÇK-s në territorin e Republikës së Shqipërisë.

II. Objektet e punës së Komisionit të Posaçëm janë:

a) administrimi i dokumentacionit dhe konkluzioneve të nxjerra nga verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të APKiE-s, *Dick Marty*;

b) hartimi i një raporti të plotë përmbledhës dhe informues për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë këto institucione, nga verifikimet e kryera për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare,

¹Me vendimin nr. 23/2021, datë 22.2.2021 u vendos:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues, për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, *Dick Marty*, për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 71/2020, zgjatet për një periudhë 3-mujore nga data e përfundimit të këtij afati.

nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të UÇK-s në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit harton një raport të detajuar përmbledhës dhe informues për të gjitha këto çështje dhe t'ia prezantojë Kuvendit të Shqipërisë, brenda një afati kohor 3-mujor (tremujor).

IV. Komisionit të Posaçëm të Kuvendit i vihet në dispozicion dokumentacioni i plotë që disponojnë institucionet publike, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentacionin zyrtar dhe atë të klasifikuar.

V. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit, në përfundim të punës, sipas objektit dhe raportit të miratuar përmbledhës, harton një projektrezolutë të Kuvendit të Shqipërisë për çështjet e mësipërme.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 26.11.2020